

Genc Kastrati e Helga Saraçi mësojnë turistët të kërcejnë

Të huajt mësojnë vallet shqiptare për dhjetë ditë

Nisma e holandezit Cees Hillebrand, ku mësohet nga pognishtja, te vallja e zileve

ALMA MILE

Njërit prej tyre i pëlqen vallja e Osman Takës. Edhe një vendas do të mendohej mirë përpara se të guxonte të dilte në valle.

Dikujt tjetër, vallja e Librazhdit. Është më individuale, më ritmike... Prej disa ditësh që ndodhen në Tiranë ata po mundohen të kapin thelbin e këtij vendi. Dhe këtë nuk mund ta bësh më mirë se duke njohur folklorin shqiptar, këngët, vallet, veshjet... E, në veçanti vallet, të cilat nuk kanë qejf vetëm t'i shohin, por edhe t'i kërcejnë. Bëhet fjalë për një grup turistësh të huaj, të cilët, pasi kanë mësuar e parë shumëçka që i duhet një turisti, kanë shprehur dëshirën të zhvillojnë një kurs gjatë të cilit të mësojnë të kërcejnë vallet shqiptare dhe të marrin disa leksione mbi muzikën, veshjet dhe traditën popullore. Kursi po zhvillohet prej disa ditësh në ambientet e Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore, ku valltarët profesionistë të këtij institucioni, me durim po u mësojnë lëvizjet e valleve të Jugut, të Shqipërisë së Mesme e të Veriut. Ndërsa për leksionet e tjera po bashkëpunohet edhe me specialistët e Institutit të Kulturës Popullore. Seminari është një iniciativë personale e holandezit Cees Hillebrand, i cili vite më parë, kur Shqipëria ishte ende nën diktaturë, kishte dëgjuar kalimthi muzikë shqiptare e qysh atëherë ëndërronte të vinte e të mësonte më shumë mbi të. Dje, në orën 17:30, pas një vizite në Shkodër, zhvilluan orën e radhës. E nisën me polifoninë e Jugut. Me këngën e shkruar përpara përpiqen të këndojnë shumëzërash një nga perlat e Jugut: "Janinë ç'i panë sytë". E çuditshme, por ia arrijnë. Këngëtarët profesionistë të Ansambllit mundohen t'i fusin në atë



(Lart) Grupi i turistëve të huaj duke kërçyer pognishten, në qendër, Genc Kastrati.

(Djathtas) Duke mësuar këngë polifonike.

Dje, gjatë orës

ELBASAN

Rinisin gërmimet në mozaikun paleokristian



Nga gërmimet në Elbasan


ELBASAN - Pas rreth katër vitesh nga zbulimi i mozaikut paleokristian në qendër të qytetit të Elbasanit, shumë pranë Portës së Kalasë, arkeologët e Institutit Arkeologjik kanë nisur punën për pastrimin dhe gërmimin e mozaikut. Arkeologu Elio Hobdari, i cili po drejton punimet për pastrimin dhe vijimin e zbulimit të mozaikut, thotë se "punimet kanë nisur me një pastrim intensiv, pasi bazilika thuhet se ishte braktisur fare nga institucionet përgjegjëse. Edhe pse nuk është detyrë e jona, ne kemi nisur punën për pastrimin e ambientit rreth mozaikut dhe afreskut zbuluar katër vjet më parë", thotë arkeologu. Sipas tij, "tashmë kemi nisur gërmimin, por politika jonë ka qenë që të gërmojmë ngadalë dhe ta mbajmë kantierin hapur sa më shumë kohë që të jetë e mundur, pasi në momentin që puna mbaron, atëherë objekti kthehet në vendgrumbullim plehrash dhe monumenti rrezikon identitetin e tij". Fatmirësisht, që nga viti 2007, kur edhe nisën gërmimet, mozaiku nuk ka pasur dëmtime. Arkeologët do të gërmojnë gjatë muajve gusht dhe shtator, ndërsa mësohet se rezultatet janë premtuese. Kohë më parë arkeologët kanë

muzikë shqiptare e dyn atëherë ëndërronte të vinte e të mësonie më shumë mbi të. Dje, në orën 17:30, pas një vizite në Shkodër, zhvilluan orën e radhës. E nisën me polifoninë e Jugut. Me këngën e shkruar përpara përpigën të këndojnë shumëzërash një nga perlat e Jugut: "Janinës ç'i panë sytë". E çuditshme, por ia arrijnë. Këngëtarët profesionistë të Ansambllit mundohen t'i fusin në atë botë mistike që pësjtjell polifoninë...

VALLET

Por, momentet më të këndshme janë, pa dyshim, ato të mësimi të valleve. Bëhen gati me të shpejtë. Veshin nga një bluzë të bardhë me shqiponjë në shpinë dhe bëhen njësh me ritmin. Për t'i futur në hulli, e fillojnë me pogonishten. Të kapura dorë për dorë, me në krye balerinën Helga Saraçi, ato hedhin një nga një hapat... Pastaj një valle e kënduar përmetare: "Poshtë nga çairët". Valltari Genc Kastrati i jep ritëm valles duke u demonstruar lëvizjet, pas të cilave ata mrekullohen... Pas këtyre valleve të shtruar ndryshon ritmi. Është "vallja e zileve. Më ritmike, më e lodhshme. Pak më të moshuarit bëjnë mënjanë nga grupi. U duhet të marrin pak frymë. Ndërsa të tjerët janë tërësisht të përpirë nga lëvizjet. Pastaj një tjetër ritëm, "vallja e Librazhdit"... Pas disa orësh mësimi nën drejtimin e kërcimtarëve profesionistë ata janë në gjendje të kërcëjnë disa nga vallet më të njohura shqiptare, madje dhe më mirë se shqiptarët. Sipas Kastratit, pas seminarit të një viti më parë, ky është i dyti, i cili ka nisur qysh në datën 8 gusht e mbyllet më 19 gusht. Këtë vit kohëzgjatja ka qenë më e madhe, pasi në qendër të tij nuk ka qenë vetëm vallja shqiptare, por edhe kënga. "Përveçse kanë mësuar valle dhe tani po mësojnë edhe polifoninë, ata kanë qenë në Malësinë e Kelmendit, në Logun e Bjeshkëve, e kanë parë nga afër mënyrën se si njerëzit e këtyre zonave jetojnë, kërcëjnë, këndojnë. Pra e kanë prekur me dorë jetën tradicionale shqiptare", thotë Kastrati.

Janë njerëz të thjeshtë, të shtyrë



në qendër,
Genc Kastrati
(Djathtas) Duke
mësuar këngë
polifonike.

Dje, gjatë orës
së mësimi të
valleve
shqiptare në
ambientet e
Ansambllit
Popullor.



Flet Ideatori | Seminarit

Hillebrand: Realizova ëndrrën 30-vjeçare

Kanë kaluar 32 vjet qëkur tek ai u zgjua dëshira për të mësuar më shumë mbi kulturën shqiptare. Aso kohe Shqipëria ishte e mbyllur dhe ishte e pamundur të merrje informacion prej saj. Filloi të mësojë në mënyrë të mëvetëshme, e derisa preku tokën shqiptare ajo mbeti një mister. Cees Hillebrand erdhi për herë të parë në Shqipëri në vitin 2004, kur ndoqi Festivalin Folklorik të Gjirokastrës. Mes përpjekjesh të vazhdueshme, vetëm një vit më parë ai arriti të organizojë një seminar mbi kulturën popullore shqiptare për një grup turistësh të huaj, për t'u rikthyer sërish këtë vit me të tjera plane. Hillebrand na tregon si nisi ky projekt.

Si lindi ky interes për folklorin shqiptar?

Ka qenë vitin 1979 kur kam kaluar në kufirin me Shqipërinë, në Maqedoninë Perëndimore. Kam dëgjuar muzikë shqiptare dhe u dashurova pas saj. Në vitin 1992 zhvillova një workshop me mësues të valleve shqiptare, kryesisht nga Kosova. Qysh atëherë më lindi ideja që një ditë të zhvillonim një workshop në Shqipëri, ku muzika dhe vallet janë kaq të ndryshme nga vendet e tjera përreth. Prej vitësh kisha biseduar me Gencin e Helgën dhe derisa ata u përgatitën, një vit më parë zhvilluam semi-

narin e parë, i cili doli shumë i suksesshëm. Të gjithë mbetën shumë të kënaqur e u dashuruan pas muzikës dhe valleve. Këtë vit, pesë prej tyre janë kthyer sërish.

Ju vetë keni mësuar të kërcëni valle shqiptare?

Dikur kam mësuar disa valle, por për shkak të një operacioni në gju e kam të pamundur, por dëshiroj që të ndaj dashurinë që unë kam për kulturën shqiptare me të tjerët. E vetmja mënyrë ishte që t'i ftoja të vinin këtu dhe të kishin të njëjtën eksperiencë që unë kam pasur në Shqipëri.

Do të ktheheni sërish?

Sigurisht që do të kthehem. Bashkë me Gencin dhe Helgën kemi zhvilluar workshope jashtë vendit. Kemi qenë të ftuar në Itali, më pas në Zyrin, në Suedi, në Gjermani... Projekti sa vjen e rritet. Shumë njerëz në Zyrin kanë shprehur dëshirën për të zhvilluar një seminar me ta...

Janë turistë të zakonshëm, apo të specializuar në fusha të ndryshme të kulturës?

Ata janë njerëz të zakonshëm, të cilët nuk janë të interesuar vetëm për vallet, por edhe për këngët, kostumet, jetën e popujve të ndryshëm. Këtë lloj turizmi ne e kemi zhvilluar më parë në vende të tjera, si në Greqi, Maqedoni etj., por jo në Shqipëri. Tani jemi këtu...

nga kureshtja për të mësuar më shumë për kulturën popullore shqiptare. Vijnë nga Gjermania, Holanda, Irlanda, Franca, Suedia... Janë plot 17. Disa kanë qenë në seminarin e parë dhe premtojnë të vijnë sërish.

"Jemi munduar të përzgjedhim disa valle jo shumë të vështira, të cilat kërcëhen nëpër dasmat tona, që

kërcëhen nga të gjithë, si vallja e Napolonit, Pogonishtja, 'Shamia e beqarit' etj., të cilat kërcëhen prej të gjithëve. Por ka edhe valle të veçanta, si vallja dyshe e Kavajës, vallja e vajzave të Delvinës, të cilën ata e kanë përvetësuar si të ishin shqiptarë, apo e vallja e Korçës", thotë valltari. Ka ndonjë që do të mësojë

edhe vallen e Osman Takës, madje pedagogu thotë se është një nga më të preferuarat, por që mbetet vetëm në kuadrin e dëshirës, pasi është shumë e vështirë për t'u mësuar... Por mësimi nuk mbetet këtu. Do t'i marrin me vete, do t'u mburren bashkëkombësve, e ndoshta ua mbushin mendjen të vijnë dhe ata vitin tjetër.

mundur, pasi në momentin që puna mbaron, atëherë objekti kthehet në vendgrumbullim plehrash dhe monumenti rrezikon identitetin e tij". Fatmirësisht, që nga viti 2007, kur edhe nisën gërmimet, mozaiku nuk ka pasur dëmtime. Arkeologët do të gërmojnë gjatë muajve gusht dhe shtator, ndërsa mësohet se rezultatet janë premtuese. Kohë më parë arkeologët kanë zbuluar një tjetër mozaik në një vend, që, sipas tyre, nuk e prisnin. Mësohet se piktura murale me një gjatësi prej katër metrash, zbuluar në vitin 2007, nuk do të lëvizë deri në momentin kur mozaiku të mbulohet me xham dhe do të ruhet në Muzeun Arkeologjik të Tiranës, pasi është shumë e vështirë që ta kalojë këtë dimër. Katër vjet më parë, në qendër të qytetit, fare rastësisht do të zbuloheshin themelet e një mozaiku të lashtë. Specialistë të arkeologjisë do ta vlerësonin si një ndër zbulimet më me vlerë, ndërsa kreu i Bashkisë do të ndihmonte me fonde jo të pakta për gërmimin dhe nxjerrjen në pah të pasurive të tij, mbuluar prej shekujsh. Gjatë gërmimeve të para, një grup arkeologësh zbuluan dy varre në thellësinë mbi tre metra, të cilat i përkasin shekullit V. Kjo bazilikë, sipas arkeologëve, është e ngjashme me katedralen e zbuluar para disa vitesh në Mallakastër. Nga studimet paraprake tregon se bazilika ka përmasa të mëdha dhe aktualisht është zbuluar një pjesë e Naosit dhe e Nefit Jugor. Muri që kufizon Nefin Jugor është i zbukuruar me afresk, i cili ruhet mirë. Mbi dyshemenë e bazilikës janë gjetur fragmente të një amfore nga Gaza e Palestinës, e cila tregon që bazilika paleokristiane është shkatërruar përfundimisht në fundin e shek. VI, ose në fillimin e shek. VII e.j. Punimet kanë rinisur falë edhe të një fondi prej 550 mijë euro, si një bashkëpunim midis Bashkisë së Elbasanit, drejtorit të Muzeut Etnografik, Institutit të Arkeologjisë në Tiranë. I gjendur në mes monumentit të Aqif Pashë Elbasanit dhe Rrapit të Bezistanit, mozaiku i ngjan një grope të madhe që mbushet me ujë e baltë sa herë që bie shi, apo shërben si një kosh i madh plehrash në mes të qytetit.